



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Prima / Dostava Punëho/Prilato Received/Delivery	23.02.2023	3	vite god year
Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSTICA	2026/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.315/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.315/2023 të datës 03.02.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati Koretinë Kamenicë, kundër Vendimit Nr.54/2023 të datës 12.01.2023 të Ministrisë së Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.02.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.315/2023 të datës 03.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 02.11.2022 për pozitën Specialistë të Shkencave Shoqërore (Inspektor i Arsimit) me numër reference RN00010341 në Ministrinë e Punëve të Brendshme të cilit i është refuzuar aplikacioni me Vendimin e datës 06.01.2023 me nr.54/2023, me datë 07.02.2023 ankuesi ka parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit të njëjtit i është refuzuar ankesa me vendimin e datës 12.01.2023. Me datën 02.02.2023, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 03.02.2023 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.315/2023 me numër protokollit 1311/2023, kundër Vendimit të datës 12.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores



Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli ende nuk ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës të parashtruar nga ankuesi, konstaton se është plotësuar kriteri ligjor për përfundim të procedimit administrativ e filluar me ankesën me numër A.nr.315/2023 të datës 03.02.2023 e parashtruar nga ankuesi


*sepse:*

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës, konstaton se ankuesi më datë 20.02.2023 ka parashtruar kërkesë me numër protokoli 1914/2023 për tërheqje të ankesës me arsyetimin se: *"bëjë tërheqjen e ankesës të dorëzuar me datë 03.02.2023 për shkaqe personale"*.

Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"* dhe neni 104 ku përcaktohet se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot"*, andaj duke u nisur nga veprimi administrativ i ankueses për tërheqjen e ankesës së parashtruar në Këshill, Kolegji konstaton që është plotësuar kriteri ligjor që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.315/2023 e datës 03.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.315/2023, datë 23.02.2023

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



*Vendimi i dërgohet:*

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë së Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.